



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 787 Prot.

Tiranë, më 23.01.2026

REKOMANDIM
MBI
HARTIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT
PËR MALLRA, PUNË, SHËRBIME

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP"), nisur nga çështjet më të shpeshta të konstatuara gjatë asistimit të procedurave të prokurimit, përsa i përket hartimit të dokumenteve të tenderit, mbështetur në nenin 23, shkronja "b" dhe "ç", të Ligjit Nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, (në vijim LPP), si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (në vijim "VKM") rekomandon autoritetet/entet kontraktore (në vijim AK) të mbajnë në konsideratë si më poshtë:

1. Autoritetet/entet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë që në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, në argumentimin e kriterëve të përfshijnë, jo vetëm bazën/at ligjore mbi të cilën/at janë hartuar kriteret, por edhe argumentimin teknik të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në raport me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Sjellim në vëmendje të autoriteteve/enteve kontraktore që, në nenin 78, pika 2, të VKM, përcaktohet se:

"2. Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".

Për sa më sipër, në lidhje me kërkesat për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik, AK duhet të argumentojnë edhe nga ana teknike çdo kriter të përcaktuar.

Për shembull, në rastin e kriterit të fuqisë punëtore të nevojshme për zbatimin e kontratës, AK duhet të hartojnë analiza teknike, ku të parashikohet fuqia punëtore, mjetet dhe makineritë që nevojiten për secilin zë punimesh, sipas afateve të parashikuara në grafikun e punimeve dhe mbi bazën e analizave përkatëse, të përcaktohet numri i punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate.

2. Në vijim të rekomandimit të mësipërm, është konstatuar se, gjatë asistimit të procedurave të prokurimit për punë publike, AK-të përcaktojnë shpesh kërkesa për disponimin e kategorive të licencave profesionale për zbatimin e punimeve të ndërtimit, të cilat nuk përputhen me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen ose nuk janë të përfshira në preventivin e punimeve, apo kërkesa që stafi inxhinierik i kërkuar në rolin e drejtuesit teknik të licencës së shoqërisë, nuk i korrespondon kategorive të licencave respektive të nevojshme.

Gjithashtu, vihet re që, AK-të përcaktojnë kriteret në lidhje me fuqinë punëtore që duhet të disponojnë OE-të, por ndërkohë në procesverbalin për argumentim dhe miratim të specifikimeve dhe kriterëve për kualifikim, nuk argumentojnë teknikisht kriterin mbi fuqinë punëtore të kërkuar.

Për sa më sipër, sjellim në vëmendje të autoriteteve/enteve kontraktore që kriteret e vendosura duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, si dhe duhet të kufizohen vetëm në ato kriteret që janë të nevojshme për të garantuar kapacitetet e nevojshme të operatorit ekonomik për zbatimin e kontratës konkrete që prokurohet.

AK duhet të mbajnë në konsideratë parashikimet e nenit 77 të LPP ku përcaktohet se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

Për këtë qëllim, për procedurat e prokurimit “punë publike”, autoritetet/entet kontraktore të mbajnë në konsideratë si më poshtë vijon:

Së pari, kategoritë e licencave profesionale duhet të përcaktohen në përputhje me zërat që parashikohen në preventivin e punimeve, si dhe çdo kategori e kërkuar të detajohet me zërat respektivë të secilës kategori në procesverbalin që hartohet për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve dhe kriterëve për kualifikim.

Së dyti, personeli kryesor apo drejtuesi/drejtuesit teknikë të kërkuar të përcaktohen në përputhje me kategoritë e licencave të kërkuara për zbatimin e punimeve.

Së fundmi, në lidhje me fuqinë punëtore, AK-të duhet të specifikojnë llojin/profilin e punonjësve të kërkuar (punëtorë + specialistë), sipas punimeve apo veprimtarive konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, dokumentacionin dëshmuës, si edhe të argumentohet teknikisht nëpërmjet analizës teknike numri i kërkuar, i cili përcaktohet në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut të zbatimit të punimeve.

Gjithashtu, në lidhje me këto procedura, AK duhet të mbajnë në konsideratë edhe mundësinë e ekuivalentimit të licencave profesionale për operatorët e huaj.

3. APP sugjeron që autoritetet/entet kontraktore, gjatë hartimit dhe argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, duhet të mbajnë në konsideratë edhe ndryshimet që mund të ketë pësuar legjislacioni që rregullon fushën specifike ku përfshihet kriteri, duke iu referuar akteve të përditësuar për hartimin dhe argumentimin e kriterit përkatës.
4. Në lidhje me shkurtimin e afatit për pranimin e ofertave, legjislacioni në fushën e prokurimit publik njih si mundësi në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, konkretisht nëni 42, pika 6, i LPP-së, parashikon se: *“6. Përfshimisht, për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor argumenton se për shkak të një gjendje urgjence e ka të pamundur respektimin e afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, afati i pranimit të ofertave mund të shkurtohet deri në 15 ditë nga data në të cilën është publikuar njoftimi i kontratës. Në çdo rast, argumentimi mbi arsyet e shkurtimit të këtij afati do të jepet nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e kontratës”.*

Sjellim në vëmendje se, aplikimi i nenit 42, pika 6, për shkurtimin e afatit për pranimin e ofertave, është i lejuar ligjërisht vetëm në rastet përjashtimore të argumentuara nga AK dhe kur situata e krijuar nuk ka ardhur për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të AK.

Pra, ky parashikim ligjor kërkon që AK të ndodhet në një situatë urgjence, i cili duhet të argumentojë që kjo situatë nuk ka qenë e mundur të parashikohet ose nuk ka ardhur nga veprime apo mosveprime të autoritetit kontraktor.

Për sa më sipër, duke pasur në konsideratë që qëllimet e LPP janë:

- Të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- Të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- Të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- Të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; si dhe
- Të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik,

Rekomandojmë, AK të marrin masat në kohë me qëllim shmangien maksimalisht të përdorimit të kësaj klauzole për shkurtimin e afatit të pranimit të ofertave.

5. Në rastet e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, vihet re se në kriteret e veçanta të kualifikimit apo në shtojca të tjera të dokumenteve të tenderit, autoritetet kontraktore në kërkesat e tyre përfshijnë përcaktime që kanë të bëjnë me paraqitjen e dokumenteve të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, ndërkohë që në njoftimin e kontratës lejojnë mundësinë e hartimit të ofertave si në gjuhën shqipe, po ashtu edhe në atë angleze.

Neni 24, pika 2, i VKM, përcakton: “2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në **gjuhët shqip ose anglisht**. ...”.

Dispozita e mësipërme lejon që autoritetet kontraktore të pranojnë që dokumentet e ofertës nga operatorët ekonomikë të mund të paraqiten edhe në gjuhën angleze përveç gjuhës shqipe.

6. Në lidhje me përzgjedhjen e kriterëve për shpalljen e ofertës fituese, në rastin kur autoritetet/entet kontraktore bazohen në *kriterin e ofertës ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto*, vihet re se nga ana e autoriteteve/enteve mungon argumentimi dhe dokumentimi i vendosjes së secilit prej kriterëve që do të përdoren dhe pikëzimit përkatës (pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm).

Ndaj, APP rekomandon që, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, AK duhet **të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter. Konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm**, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet e nenit 45, të VKM.

Gjishashtu, sjellim në vëmendje të AK, që në rastin e përdorimit të këtij kriteri mund t'i referohen edhe “*Udhërrëfyesit Mbi përdorimin nga autoritetet kontraktore të kriterit të vlerësismit “Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto”*”, i cili gjendet i publikuar në faqen e APP dhe mund të aksesohet në linkun:

<https://app.gov.al/GetData/DoenloadDoc?documentId=455cad8e-eda5-4b54-b227-ee3598810811>.

7. Zbatimi dhe respektimi i legjislacionit mjedisor është një detyrim si për autoritetet/entet kontraktore, ashtu edhe për operatorët ekonomikë (në vijim OE).

Konkretisht, në nenin 3, pika 3, të LPP, përcaktohet se: “3. *Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*”

Gjithashtu, në nenin 26, pika 2, shkronja “f”, të VKM, përcaktohet: “2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: ... f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;...*”

Për autoritetet/entet kontraktore, kërkesat për zbatimin e legjislacionit mjedisor fillojnë që në hartimin e specifikimeve teknike, ku mund të përcaktojnë karakteristika të punëve/mallrave/shërbimeve që përfshijnë edhe ndikimin mbi mjedisin apo karakteristika të ndryshme mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të sakta e të matshme.

Në kriteret që përcaktojnë ofertën ekonomikisht më të favorshme, autoritetet/entet kontraktore mund të përfshijnë kërkesa që lidhen me karakteristika mjedisore, si edhe mund t'i referohen edhe Udhërrëfyesit "Mbi zbatimin e prokurimit publik të gjelbër në procedurat e prokurimit publik", që gjendet i publikuar në faqen e APP në linkun:

<https://app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=5078178e-5e90-4136-a494-b341b7998e16>.

Po ashtu, gjatë hartimit të kontratës, ato mund të vendosin kushte të veçanta për zbatimin e saj, ku përfshihen edhe faktorë mjedisorë.

Ndërkohë, në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoritetet/entet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë se, kriteret që lidhen me zbatimin e legjislacionit mjedisor përcaktohen në rastet kur kanë lidhje me natyrën dhe objektin e kontratës, me kërkesat e tjera të përcaktuara nga autoritetet/entet kontraktore në dokumentet e tenderit dhe nëse ato janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues ka kapacitetet e nevojshme për zbatimin e kontratës që do të jepet.

8. Në kriteret që kanë të bëjnë me disponimin e fuqisë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, kryesisht në procedurat e prokurimit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, gjatë procesit të asistimit nga APP është konstatuar një mospërputhje ndërmjet numrit total të personelit të kërkuar dhe kriterëve konkrete për certifikimin profesional të tyre.

Konkretisht, në dokumentet e tenderit përcaktohet kërkesa për një numër punonjësish në total dhe, në vijim, kërkohen certifikatat profesionale, të cilat, në total korrespondojnë me një numër më të lartë punonjësish, ndërkohë që në të njëjtin kriter parashikohet gjithashtu se një punonjës mund të zotërojë më shumë se një certifikim profesional.

Për sa më sipër, në hartimin e këtyre kriterëve, AK duhet të mirëpërcaktojë kërkesat që ato i konsiderojnë të domosdoshme për ekzekutimin e kontratës, duke shmangur përcaktime të paqarta apo që lënë vend për interpretim, me qëllim që, për kriteret që në thelb përmbajnë të njëjtat kërkesa, të mos ketë dy apo më shumë përcaktime të ndryshme.

9. Në lidhje me kriterin për drejtuesit e mjeteve, konkretisht për mënyrat e lejuara të disponimit të tyre, vihet re se në një numër të konsiderueshëm të rasteve, autoritetet/entet kontraktore kërkojnë që këta punonjës të figurojnë në listëpagesat e operatorëve ekonomikë, duke mos lejuar asnjë mënyrë tjetër disponimi, ndërkohë që për mjetet të cilat

do të drejtohen nga këta punonjës lejohet disponimi në mënyra të tjera që njëj legjislacioni përkatës (të tilla si: pronësia, qiramarrja, etj).

Për sa më sipër, në këto raste, rekomandojmë që AK të lejojë mundësinë e disponimit të drejtuesve të mjeteve nëpërmjet llojeve të ndryshme të marrëdhënieve kontraktuale të punës, që parashikohen nga legjislacioni që rregullon fushën konkrete.

10. Në disa raste, është vënë re se në kriteret që kanë të bëjnë me paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve/distributorëve të autorizuar, AK vendosin përcaktime në lidhje me të dhënat që duhet të kenë këto dokumente, të tilla si: numri i referencës së procedurës së prokurimit, objekti, detajet e procedurës për të cilën ofertohet, etj.

Në lidhje me këto kritere, APP rekomandon që AK të mos përcaktojë të dhëna të detajuara të cilat lidhen me formatin e që duhet të jenë pjesë e përmbajtjes së dokumentacionit që kërkohet të paraqitet nga OE ofertues, të cilat e kufizojnë vlefshmërinë e autorizimit vetëm për procedurën konkrete, me qëllim *sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.*

11. Në disa procedura prokurimi, AK kërkojnë paraqitjen e mostrave për të gjitha mallrat objekt prokurimi megjithëse kërkesat teknike, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, mund të verifikohen nga AK edhe nëpërmjet paraqitjes së katalogëve apo skedave teknike.

Sjellim në vëmendje të AK se, kërkesa për paraqitjen e mostrave të mallit objekt prokurimi, mund të bëhet nëse vlerësohet që paraqitja e tyre i shërben KVO për të verifikuar nëse mallrat e ofertuara i plotësojnë specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, me qëllim vlerësimin e ofertës teknike.

Në këtë rast, AK duhet të argumentojë teknikisht vendosjen si kriter kualifikimi paraqitjen e mostrave, duke përcaktuar ndër të tjera edhe se cilat nga specifikimet teknike janë të nevojshme për t'u verifikuar nëpërmjet mostrave.

Në lidhje me kërkesën për paraqitjen e mostrave, AK duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet e nenit 40, pika 6, shkronja "a", të VKM.

12. Gjatë asistimit të procedurave të prokurimit për blerjen e lëndëve djegëse (naftë, gaz dhe/ose nënprodukteve të tyre), vihet re se shpeshherë kërkohet që furnizimi i automjeteve/ofrimi i mallit të kryhet nëpërmjet "tollonave"/ "biletave".

Në lidhje me këto kërkesa, sjellim në vëmendje të AK përcaktimet e VKM Nr. 561, datë 29.7.2016, "Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, sipas të cilave *njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj.*

Sa më sipër, AK duhet të shmangin përdorimin e një përcaktimit të tillë në rastin e procedurave të prokurimit për blerjen e lëndëve djegëse për automjetet.

Gjithashtu, në rastin e procedurave të prokurimit ku AK kërkon të prokurojë edhe lëndë djegëse për kalaja veç asaj për automjete (naftë), APP rekomandon të mbahen në konsideratë parashikimet e nenit 15, pika 4, të Ligjit Nr. 8450, date 24.2.1999 “Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Stacioneve të shitjes së karburanteve u ndalohet të tregtojnë karburante për mjete transporti, detar e ajror, si dhe lëndë djegëse të lëngëta apo të gazta”.

Sa më sipër APP, për të realizuar procedurën në fjalë dhe për të nxitur konkurrencën, rekomandon vlerësimin e mundësisë së ndarjes së procedurës në lote.

13. Në një numër të konsiderueshëm rastesh, është vënë re se autoritetet/entet kontraktore, për procedura prokurimi me vlerë nën kufirin e ulët monetar, për zgjedhin në sistemin e prokurimit elektronik llojin e procedurës “E hapur”, çfarë sjell si pasojë jo vetëm përdorimin e dokumenteve standarde të tenderit, por edhe hartimin e kërkesave dhe kritereve të veçanta të kualifikimit, sipas së njëjtës lloj procedure.

Në nenin 49, pika 1, të LPP, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e hapur të thjeshtuar për kontrata nën kufirin e ulët monetar.”

Pra, ligji iu jep mundësinë AK që, sipas vlerësimit të tyre, për kontrata nën kufirin e ulët monetar, ato të përdorin procedurën e hapur të thjeshtuar.

Referuar qëllimeve të LPP, veçanërisht nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik si dhe nxitjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, APP sugjeron që në rastin e procedurave të prokurimit nën kufirin e ulët monetar, AK të hartojnë kritere sa më të thjeshta kualifikimi për operatorët ekonomikë, duke mbajtur në vëmendje përcaktimet e nenit 55, pika 4, të VKM, sipas të cilës:

“4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:

a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.

Sa më sipër, në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, AK duhet të përdorin “Procedurën e hapur e thjeshtuar”, dhe të vendosin kriteret e thjeshtuara pranimit me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, ndërkohë mund të përdorin një afat më të gjatë se sa minimumi i lejuar, për pritjen e ofertave, nëse e vlerësojnë të arsyeshme dhe nevojshme.

14. Së fundmi, sjellim në vëmendje të autoriteteve/enteve kontraktore se, ndër kompetencat/detyrat e nëpunësve të përfshirë në proceset e prokurimit, konkretisht të personave përgjegjës për prokurimin, sipas nenit 74, pika 3, shkronja “f”, të VKM, është edhe ajo e bashkërendimit të punës me APP, me qëllim realizimin e detyrës së hartimit të dokumenteve të tenderit me efikasitet dhe në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi.

Po ashtu, ndër përgjegjësitë e titullarit të autoritetit kontraktor, apo të personit të autorizuar prej tij, bazuar në nenin 21, pika 5, të LPP, përfshihet edhe mbikëqyrja e të gjitha proceseve të parashikuara në nenin në fjalë.

Në funksion të përmbushjes së kompetencave/detyrave të sipërcituara, AK duhet të mirëpërcaktojnë të dhënat e kontaktit të personave përgjegjës, titullarëve të autoriteteve/enteve apo personave të autorizuar prej këtyre të fundit [emër, mbiemër, email-et zyrtare (nëse disponohen) dhe në mungesë të tyre, email aktiv/funksional], me qëllim sigurimin e integritetit, besimit publik dhe transparencës në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe bashkërendimin e plotë të punës mes palëve të përfshira në procesin e asistimit.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Reida KASHITA